



Drejtuar: Shoqërisë “Muça” shpk
Adresa: Vore,Picar, Autostrada Tirane- Durres, KM 13, Tirane

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: e zgjedhur në bazë të Nenit 34 të Ligjit Nr. 9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Kreu IV,Neni 39 është **“Kërkesë për Propozim”**.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Paisje të ndryshme për zyrat”**.

Fondi limit: **4.195.000 (katërmilion e njëqind e nëntëdhjetë e pesëmijë)** lekë pa tvsh.

Burimi i financimit: Të ardhura - vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës në mbështetje të VKB Nr.58 datë 23.12.2015 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2016-2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016”..

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **11.07.2016 ora 11.00**

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: **Buletini i Njoftimeve Publike Nr 26 datë 04.07.2016.**

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “Muça” shpk

NUIS- K01421002H

Vlera e Ofertës pa tvsh **4.174.000 (katërmilion e njëqind e shtatëdhjetë e katërmijë)** lekë.

2. Operatori ekonomik “Buna” shpk

NUIS-J61826501C

S’ka paraqitur oferte ekonomike

3. Operatori ekonomik “Erald G” shpk

NUIS- J74517205P

S'ka paraqitur oferte ekonomike

4. Operatori ekonomik "Bolt" shpk

NUIS-K91517011V

Vlera e Ofertës pa tvsh **4.145.000 (katërmilion e njëqind e dyzet e pesëmijë) lekë.**

5. Operatori ekonomik "Epipllo Dekor" shpk

NUIS- K3128636P

Vlera e Ofertës pa tvsh **3.540.000 (tremilion e pesëqind e dyzetmijë) lekë.**

6. Operatori ekonomik "Erzeni/SH" shpk

NUIS-J66902027T

Vlera e Ofertës pa tvsh **4.120.000 (katërmilion e njëqind e njëzetmijë) lekë.**

7. Operatori ekonomik "M.Lezha" shpk

NUIS-J61826501C

Vlera e Ofertës pa tvsh **3.105.000 (tremilion e njëqind e pesëmijë) lekë.**

Janë skualifikur ofertuesit e mëposhtëm

**1. Operatori ekonomik "Buna" shpk
Përkatësisht për arsyet e mëposhtme**

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria "Buna" shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar tek kriteret e vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumenteve të tenderit për këtë procedurë. Gjithashtu kjo shoqëri nuk ka paraqitur në ditën dhe orën e hapjes së ofertave as mostrat për artikujt e zërave të preventivit të kërkuar në dokumentat standarte të tenderit duke mospërmbushur piken 9 të kapacitetit teknik të kriterëve të vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave standarte të tenderit.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik "Buna" shpk s'kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Çmimit të Ofertës sipas Shtojcës 1, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor në dokumentat e tenderit për këtë procedurë si dhe nuk ka paraqitur mostrat e kërkuara në Dokumentat standarte të tenderit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik", e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Operatori ekonomik “Erald G” shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “Erald G” shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike të kërkuar tek kriteret e vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumenteve të tenderit për këtë procedurë. Gjithashtu kjo shoqëri nuk ka paraqitur në ditën dhe orën e hapjes së ofertave as mostrat për artikujt e zërave të preventivit të kërkuar në dokumentat standarte të tenderit duke mospërbushur piken 9 të kapacitetit teknik të kriterëve të vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave standarte të tenderit.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik “Erald G” shpk s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur Formularin e Çmimit të Ofertës sipas Shtojcës 1, kërkesë kjo e përcaktuara Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor në dokumentat e tenderit për këtë procedurë si dhe nuk ka paraqitur mostrat e kërkuara në Dokumentat standarte të tenderit.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreut VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

3. Operatori ekonomik “Bolt” shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga kjo shoqëri, nga ku rezultoi si më poshtë:

- *Shoqëria “Bolt” shpk nuk ka paraqitur në ditën dhe orën e hapjes së ofertave mostrat për artikujt e zërave të preventivit të kërkuar në dokumentat standarte të tenderit duke mospërbushur piken 9 të kapacitetit teknik të kriterëve të vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave standarte të tenderit.*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

3. Operatori ekonomik “Epipllo Dekor” shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga kjo shoqëri, nga ku rezultoi si më poshtë:

- *Shoqëria ”Epiplo Dekor” shpk nuk ka paraqitur në ditën dhe orën e hapjes së ofertave mostrat për artikujt e zërave të preventivit të kërkuar ne dokumentat standarte te tenderit duke mospërmbushur piken 9 të kapacitetit teknik të kriterëve të vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave standarte të tenderit.*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

5. Operatori ekonomik “Erzeni/SH” shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga kjo shoqëri, nga ku rezultoi si më poshtë:

Ne mostrat e paraqitura nga operatori ekonomik ”Erzeni/ SH” shpk u konstatua nga ana e komisionit se ato nuk jane ne përputhje me specifikimet teknike te përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor ne dokumentat e tenderit per sa me poshte vijon:

- Ne ndryshim nga firma e pare ngjyrat e syprinave jane ngjyre qershi e erret . Neper qoshe plastifikimi ka carje (plasaritje) .
- Plastika eshte e holle .
- Per etazherin kapaku poshte eshte paraqitur me melamine por eshte kerkuar me MDF te plastifikuar . Melaminar e paraqitura kane ciflosje te vogla .
- Stoli vendesh nuk montohet ne dysheme .
- Poltroni eshte lekure e zeze
- Karriget jane me cope blu te hapur .

Komisioni i vlerësimit të ofertave duke ju referuar mostrave të paraqitura konstaton se operatori ekonomik nuk plotëson specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në dokumentat e tenderit duke mos plotësuar kriteret e vecanta për kualifikim kapaciteti teknik pika 9.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Neni 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

6. Operatori ekonomik “M.Lezha” shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të neni 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga kjo shoqëri, nga ku rezultoi si më poshtë:

Ne mostrat e paraqitura nga operatori ekonomik “M.Lezha” shpk u konstatua nga ana e komisionit se ato nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor në dokumentat e tenderit për sa më poshtë vijon:

- **Karrige pune:** permasat duhet të jënë 58x54 janë 54x50. Tekstili I përdorur është gri me cirga të zeza (jo fort cilësore), nderkohe kërkesa është gri, zeze ose e kuqe (jo me cirga)
- **Karrige rrotulluese.** Permasat janë disa cm më të mëdha se kërkesa jone. Tekstili është I njëjti me elementin 1 (gri me cirga të zeza)
- **Tavoline pune me kasetiere** Është paraqitur vetëm suprina me permasa dhe material sipas kërkesës. Ndryshe anon nga e verdha dhe jo pa sic është kërkuar nga ne. Elementet e tjera të pa paraqitur.
- **Tavoline kompjuteri.** Ngjyra jo njësoj sic është kërkuar. Plastifikimi me difekt, sidomos në pjesën anësore (cep) janë të çrëta. Jo të gjitha elementet.
- **Tavoline drejtuesi harkore.** Ka po të njëjtat problematika, ngjyra që anon nga e verdha dhe difekt në plastifikim.
- **Etazhere për zyra** Është paraqitur vetëm një kapak (lart), ndërsa kapaku poshtë jo. Materiali nuk është MDF I plastifikuar sipas kërkesës por melamine 18 m/m, e borduar me PVC 1m/m që nuk korrespondon me ngjyrën e melamines. Edhe ajo që është paraqitur nuk e ka punimin cilësor (ka çiflojë të dukshme)
- **Dollap për mbajtje dokumentacioni** Elementi i vetëm i paraqitur është një kapak me melamine 18 m/m ngjyra pa të verdhë e bombarduar me PVC 1 m/m jo në ngjyrën e kapakut.
- **Raftet metalik për arkive** Është paraqitur një element I tërë (I pa montuar) me 5 ndarje horizontale për vendosje materiale.
- **Stola metalik për pritje 3 vendesh.** Nuk mund të montohen në dysheme por janë të levizshëm.

Komisioni i vlerësimit të ofertave duke ju referuar mostrave të paraqitura konstaton se operatori ekonomik nuk plotëson specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në

dokumentat e tenderit duke mos plotesuar kriteret e vecanta per kualifikim kapaciteti teknik pika 9.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë shoqërinë **“Muça” shpk me adresë:** Adresa: Vore, Picar, Autostrada Tirane- Durres, KM 13, Tiranë, se oferta paraqitur, me një vlerë të përgjithshme pa t.v.sh **4.174.000 (katërmilion e njëqind e shtatëdhjetë e katërmijë) lekë, është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitorja “Dëshmorët e Kombit”, nr.1, 1001, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Ankesa: Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në këtë procedure prokurimi në mbështetje të nenit 63 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, nuk është paraqitur asnjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktor në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

